



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrië
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 21 maj 2026 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:40.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Stefan Markoviç (kryesues), Behar Duraku, Gresa Muli, Fakete Dushi, Diellza Pllana, Miljan Bojkoviç, Berat Maloku, Florije Ramadani dhe Bekim Çuni, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Branislav Vuksanovic, udhëheqës i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Ekrem Merovci, koordinatori për kthim dhe riatdhesim, Aktëre Dërvari, përkthyesë, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it slloven si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Stefan Markoviç, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë.

Ai tha se i vjen mirë që është pjesë e këtij komiteti, ku bashkërisht do të punojmë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.

Meqë nuk jemi në fillim të vitit, nuk kemi bërë plan të punës, për shkak se puna e komitetit filloi vonë. Nëse pajtoheni, këtë vit t'i propozojmë temat së bashku, duke u bazuar përafërsisht në planin e punës së vitit të kaluar. Kurse, në vitin tjetër e bëjmë planin e punës me kohë.

Gresa Muli, anëtare e komitetit – pasi që themelimi i komitetit u vonua, e dimë që është problem të bëhet një plan vjetor në gjysmë të vitit. Ne që jemi anëtarë të kuvendit e dimë pak a shumë se çka i preokupon komunitetet. Andaj, propozoj që ta krijojmë një grup në “Viber” dhe paraprakisht të koordinohemi për caktimin e temave që do të diskutohen në mbledhjet e komitetit.

Stefan Markoviç, kryesues i komitetit- tha se do ta krijojmë grupin në “Viber” dhe do të diskutojmë paraprakisht për temat.

Komiteti për Komunitete me tetë (8) vota “për” dhe një (1) “abstenim” vendosi që ta krijojë një grup në “Viber” për të diskutuar anëtarët e komitetit paraprakisht për temat.

Komiteti për Komunitete me tetë (8) vota “për” dhe një (1) “abstenim” aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Diskutim i hapur për gjendjen ekologjike në territorin e komunës së Vushtrrisë;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Diskutim i hapur për gjendjen ekologjike në territorin e komunës së Vushtrrisë.

Stefan Markoviç, kryesues i komitetit- lidhur me gjendjen ekologjike në vendin tonë dihet se ka probleme. Ai tha se duhet të bëhet pastrimi i mbeturinave, rrugëve, lumenjve, ujit të pijshëm, ndërrimi i kontejnerëve.

Bekim Çuni, anëtar i komitetit – tha se varrezat e komunitetit ashkali në Vushtrri janë në një gjendje të keqe. Për shkak se janë mbushur shumë bari, është e pamundur të vizitohen. E kam përgatitur një kërkesë me shkrim për këtë çështje, ose ua dorëzojë juve ose e dorëzojë në komunë. Përmes kësaj kërkesë do të kërkojmë pastrimin e varrezave. Më herët i kemi pastruar vet, ku jemi organizuar si komunitet dhe diaspora ka participuar.

Branislav Vuksanoviç, udhëheqës i Zyrës për Komunitete dhe Kthim – asnjëherë nuk ka pasur më shumë shërbime për mbledhjen e mbeturinave dhe ka aq shumë mbeturina. Aty ku jetoj unë në Prelluzhë, ka njerëz të pandërgjegjshëm që hudhin mbeturina në vende jo adekuate dhe kështu krijojnë deponi ilegale. Kompania për mbledhjen e mbeturinave e bën punën e vet, ka raste kur nganjëherë vonohen. Por, megjithatë e kryejnë punën e tyre.

Më herët kemi pasur problem me personat që nuk kanë bërë pagesë të mbeturinave, kur për shkak të tyre kanë pësuar edhe qytetarët tjerë që kanë paguar. Prandaj, duhet t'i lajmërojmë në organet kompetente qytetarët që hudhin mbeturina në vende jo adekuate. Po ashtu, organet kompetente t'i pastrojnë këto deponi. Ai bëri apel që inspeksioni të ndërmer masa që të mos rrezikohen qytetarët nga ndonjë epidemi.

3. Të ndryshme.

Diellza Pllana, anëtare e komitetit – kërkoi që orari për mbajtjen e mbledhjeve të komitetit të jetë pasditë, për shkak se si studente në Fakultetin e Mjekësisë jam e angazhuar paradite që të bëj praktikë për stazh. Ajo propozoi që mbledhjet t'i mbajmë nga ora 14:00. Kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj për këtë çështje.

Stefan Markoviç, kryesues i komitetit- tha se në muajin e ardhshëm do të marrë pjesë në një konferencë, kisha propozuar që mbledhjen muajit qershor ta mbajmë më herët, diku 11 apo 12 qershor.

Komiteti për Komunitete njëzëri vendosi që mbledhjet të mbahen në ora 14. Kurse, mbledhja e muajit qershor të mbahet më 11 qershor 2026 në ora 14:00.

Mbledhja përfundoi në ora 11:10.

Bujar Klinaku

B.Klinaku
Procesmbajtës



Stefan Markoviç

SM
Kryesues i K. për Komunitete